



Институт за човекови права



Auswärtiges Amt



HUMAN RIGHTS

*Kuadri ligjor, sfidat dhe perceptimi i bazave të diskriminimit*

# DISKRIMINIMI NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT



**DISKRIMINIMI NË  
REPUBLIKËN E  
MAQEDONISË SË VERIUT:**

**KUADRI LIGJOR, SFIDAT DHE  
PERCEPTIMI I BAZAVE TË  
DISKRIMINIMIT**

**DISKRIMINIMI NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT:**  
**KUADRI LIGJOR, SFIDAT DHE PERCEPTIMI I BAZAVE TË DISKRIMINIMIT**

Editor:

**Instituti për të Drejtat e Njeriut**

Autore:

**Margarita Caca Nikollovska**

Redaktor:

**Antonio Pavlovski**

Përktheu:

**Blerina Starova Zllatku**

Vendi dhe viti i botimit:

**Shkup, dhjetor 2020**

---

Ky publikim u hartua me mbështetje financiare të Ambasadës së Gjermanisë. Përmbajtja e tij është në përgjegjësi të Institutit për të Drejtat e Njeriut dhe nuk i pasqyron pikëpamjet e Ambasadës së Gjermanisë ose Qeverisë.



Auswärtiges Amt



HUMAN RIGHTS

# PËRMBAJTJA:

Shënime hyrëse .....	5
1. Retrospektiva historike e kuadrit ligjor të diskriminimit .....	7
2. Sfidat e Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi – nga ngritja e procedurës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së tij deri në shfuqizimin nga Gjykata Kushtetues.....	10
3. Ndalimi i diskriminimit sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe standardeve të vendosura nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut .....	15
4. Sfidat dhe miratimi i Ligjit të ri për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi .....	20
5. Perceptimi i diskriminimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut me theks të veçantë mbi bazat e diskriminimit: Orientimi seksual dhe identiteti gjinor .....	23
Pikëpamje përfundimtare .....	25
Bibliografia .....	27

## SHËNIME HYRËSE

Diskriminimi si dukuri ka efekt negativ në një shoqëri dhe çon në krijimin e paragjytimeve dhe perceptimeve negative tek njerëzit për një gjendje të caktuar, me ç'rast diversiteti perceptohet më shumë si problem sesa si përfitim. Qëllimi i përgjithshëm në luftën kundër diskriminimit konsiston me mundësinë e qasjes së barabartë dhe të drejtë në mundësitë që i ofron një shoqëri.

Kjo analizë ka për qëllim ta pasqyrojë gjendjen e diskriminimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut përmes retrospektivës të rendit kushtetues dhe kuadrit ligjor deri në problemet që kanë të bëjnë me shfuqizimin e Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi dhe miratimin e ligjit të ri në tetor të vitit 2020. Periudha kohore në të cilën nuk ekzistonte rregullimi ligjor i diskriminimit, në kuptimin e ligjit *lex specialis*, ishte një shkas i mirë t'i jepet mundësi zbatimit të drejtpërdrejtë të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe standardeve të vendosura të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në përcaktimin e diskriminimit, konform nenit 14 dhe nenit 1 të Protokollit 12 të Konventës. Megjithatë, rrethanat e vënë në dukje se qytetarët nuk janë mjaftueshëm të motivuar të iniciojnë procedura gjyqësore për dëshmimin e veprimeve të diskriminimit ose kanë frikë nga reperkusionet nëse publikisht pranojnë se kanë qenë të diskriminuar mbi cilëndo qoftë bazë.

Duke e pasur parasysh këtë që u tha më lartë, kjo analizë do të përpiket t'i prezantojë shkaqet e mundshme për gjendjet e këtilla përmes pasqyrimit të perceptimit të diskriminimit nga ana e popullsisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, dhe veçanërisht përmes aspektit të bazave të diskriminimit siç është orientimi seksual dhe identiteti gjinor. Rezultatet nga sondazhi i realizuar, me kërkesë të Institutit për të Drejtat e Njeriut, vunë në pah se Republika e Maqedonisë së Veriut është një shoqëri konsiderueshëm homofobike, me shkallë të lartë të intolerancës, veçanërisht ndaj personave homoseksualë dhe transgjinorë.

Miratimi e Ligjit të ri për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi do të duhej ta ndryshojë perceptimin e lartpërmendur të qytetarëve, dhe së këtejmi duhet të lihet hapësirë për implementimin e ligjit në mënyrë që të identifikohet nevoja e plotësimit ose ndryshimit eventual të dispozitave ligjore. Brenda kësaj periudhe duhet të punohet në ngritjen e vetëdijes së njerëzve në lidhje me diskriminimin, ekzistimin e kuadrit ligjor, tolerancën ndaj diversiteteve dhe veçanërisht ndaj grupeve të marginalizuara, ndërkohë nga ana tjetër të fillojë zbatimi përkatës i Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi.



1.

RETROSPEKTIVA HISTORIKE  
E KUADRIT LIGJOR TË DISKRIMINIMIT

Diskriminimi si një fenomen i përhapur global ka reperkusione negative mbi shoqërinë dhe çon në paragjykime dhe krijimin e perceptimit negativ tek njerëzit për një gjendje të caktuar. Diversiteti nuk duhet të perceptohet si karakteristikë negative, por si pjesë e personalitetit dhe si karakter i çdo individi. Për fat të keq, për shkak të prezencës gjithnjë e më të madhe të diskriminimit, është e pamundur të ofrohet vetëm një përkufizim i cili do t'i sublimonte të gjitha karakteristikat e diskriminimit, përkatësisht do t'i përfshinte të gjitha veprimet dhe aktet e diskriminimit, veçanërisht nëse në të njëjtin nuk është përfshirë elementi i ngjashmërisë i cili ka rëndësi jashtëzakonisht të madhe.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut bazat e diskriminimit i përkufizon si “karakteristika personale sipas të cilave personat ose grupet e personave dallojnë njëri nga tjetri”, ndërsa ky dallim mund të jetë si rezultat i më shumë bazave të diskriminimit. Diskriminimi nënkupton vendosjen e një grupi të caktuar të njerëzve në pozitë të pa favorshme në situatë të caktuar, si rezultat i stereotipave dhe paragjykimeve. Parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit nga shumë qytetarë perceptohen si të barabarta, megjithatë ato dallojnë në një aspekt të rëndësishëm, që ka të bëjë me parimin e mosdiskriminimit i cili është një koncept më i ngushtë dhe para së gjithash u referohet grupeve të caktuara vulnerable në shoqëri. Kjo nënkupton se shtetet kanë detyrime të ndryshme, pozitive dhe/ose negative, të veprojnë në përputhje me parimet e barazisë edhe sa i përket ndalimit të diskriminimit. Detyrimet pozitive nënkuptojnë se shtetet, fillimisht në kushtetutat, duhet të proklamojnë barazi midis qytetarëve dhe mosdiskriminim, ndërsa nga ana tjetër detyrimet negative përbëhen në përcaktimin e sanksioneve nga ana e shtetit në rast të shkeljes së parimeve të barazisë dhe mosdiskriminimit.

Nga pikëpamja historike, edhe në kuadër të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (RSFJ), barazia midis qytetarëve, fillimisht në Kushtetutë, është trajtuar në nivelin më të lartë, pavarësisht përkatësisë kombëtare, racore, seksit, gjuhës, fesë, arsimit ose pozitës sociale.<sup>1</sup> Edhe Kushtetuta e Republikës Socialiste të Maqedonisë në nenin 204 ka parashikuar se qytetarët janë të barabartë në të drejtat dhe detyrimet, pavarësisht përkatësisë kombëtare, racës, seksit, gjuhës, fesë, arsimit ose pozitës shoqërore. Sipas Ligjit penal të Republikës Socialiste të Maqedonisë nga viti 1977, është parashikuar sanksioni për cenimin e barazisë së qytetarit. Neni 50 e përcakton si vijon: “Ai i cili mbi bazë të dallimit sipas përkatësisë kombëtare, etnike, racës, fesë, seksit, gjuhës, arsimit ose pozitës shoqërore do t’ia privojë ose do t’ia kufizojë të drejtat njeriut dhe qytetarit të përcaktuara në Kushtetutë, ligj ose në ndonjë akt tjetër normativ ose në ndonjë akt të përgjithshëm, apo i cili në bazë të këtyre dallimeve u jep qytetarëve favore ose beneficione, do të dënohet me burgim prej 3 muaj deri 5 vjet.”<sup>2</sup>

Duke e pasur parasysh këtë dispozitë mund të konstatohet se edhe në kohën e socializmit ligjvënësi në mënyrë serioze i ka trajtuar çështjet që kanë të bëjnë me diskriminimin, duke i ngritur në nivel kushtetues, e ka përcaktuar ndalimin e diskriminimit mbi më shumë baza diskriminuese dhe e ka trajtuar me seriozitet. Ky koncept në të vërtetë ka kontribuar ndalimi i

1 Kushtetuta e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, viti 1974. (shih: nenin 154).

2 Gazeta Zyrtare e Republikës Socialiste të Maqedonisë. “Ligji penal i Republikës Socialiste të Maqedonisë “. Gazeta Zyrtare nr. 25 nga data 18 qershor i vitit 1977.

diskriminimit dhe proklamimi i parimit të barazisë të konsiderohen si themel për realizimin e të drejtave dhe lirive të të gjithë personave për të cilat angazhohet çdo shtet demokratik.<sup>3</sup>

Përkrah evoluimit të diskriminimit në sisteme të ndryshme të administrimit, koncepti i rregullimit kushtetues të diskriminimit dhe ndalimi i më shumë bazave është i pranishëm edhe në Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut nga viti 1991. Hartuesi i Kushtetutës parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit e vendos në nivelin më të lartë. Barazia fillimisht përmendet në Preambulën e Kushtetutës, ku thuhet: "...të garantohen të drejtat e njeriut, liritë qytetare dhe barazia kombëtare."<sup>4</sup>

**Në mënyrë plotësuese, neni 9 i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut parashikon:**

**“Qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut janë të barabartë në liritë dhe të drejtat, pavarësisht seksit, racës, ngjyrës së lëkurës, origjinës kombëtare dhe sociale, bindjes politike dhe fetare, pozitës pronësore dhe shoqërore. Qytetarët para Kushtetutës dhe ligjeve janë të barabartë”.**

Kushtetuta e garanton barazinë edhe në nenin 33, në pjesën e realizimit të të drejtave nga marrëdhënia e punës, si edhe në nenin 44, në lidhje me të drejtën e qasjes së barabartë në arsim. Duke e pasur parasysh se garantimi i lirive dhe të drejtave megjithatë nuk mjafton që të njëjtat të gëzohen në mënyrë përkatëse nga bartësit e tyre, Kushtetuta parashikon mekanizma përkatës për mbrojtjen e këtyre lirive dhe të drejtave.

**Së këtejmi, neni 50 i Kushtetutës e ofron mundësinë:**

**„Çdo qytetar mund të thirret në mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të përcaktuara në Kushtetutë para gjykatave dhe para Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut në procedurë të bazuar mbi parimet e prioritetit dhe urgjencës”.**

Nga ana tjetër, çdo qytetar i cili mendon se i janë cenuar të drejtat e njeriut, përkatësisht se është diskriminuar mund të paraqesë kërkesë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut para Gjykatës Kushtetuese, në procedurë e cila është përcaktuar me Rregulloren e punës së Gjykatës.<sup>5</sup>

Neni 110 i Kushtetutës, në mesin e kompetencave të tjera të Gjykatës Kushtetuese, parashikon se ajo i mbron liritë dhe të drejtat e njeriut dhe qytetarit që kanë të bëjnë me lirinë e besimit, vetëdijes, mendimit dhe shprehjes publike të mendimit, bashkimin dhe veprimin politik dhe ndalimin e diskriminimit të qytetarit në bazë të seksit, racës, përkatësisë fetare, kombëtare, sociale dhe politike. Po ashtu bëhet fjalë edhe për një numër të kufizuar të bazave të diskriminimit në të cilat, mes tjerash, nuk është përfshirë orientimi seksual dhe identiteti gjinor, Gjykata Kushtetuese, në praktikën e vet, i njehtë drejtat e garantuara me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), si dhe standardet e vendosura nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të

3 Caca Nikollovska, Margarita. 2019. “Kudri ligjor i diskriminimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut: retrospektivë historike dhe pikëpamje aktuale. Dialogu juridik nr. 20, i aksesshëm në: <https://www.ihr.org.mk/storage/app/media/Legal%20Dialogue/%D0%9F%D1%80%D0%B0%D0%B2%D0%B5%D0%BD%20%D0%B4%D0%B8%D1%98%D0%B0%D0%BB%D0%BE%D0%B3.pdf>

4 Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut, “Gazeta Zyrtare” e RMV nr. 52/1991

5 Rregullorja e Gjykatës Kushtetuese të RMV, [http://ustavensud.mk/?page\\_id=4605](http://ustavensud.mk/?page_id=4605)



Njeriut (GJEDNj). Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut në nenin 118 parashikon se marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën, janë pjesë të rendit të brendshëm juridik dhe nuk mund të ndryshohen me ligj. Mund të nxirret konkluzioni se qytetarët mund të thirren në mbrojtjen e të drejtave të tyre, në përputhje me Konventën, para gjykatave nacionale, pavarësisht normave të parashikuara në Kushtetutë dhe në ligje lidhur me mbrojtjen nga diskriminimi.

Kushtetuta e ofron mundësinë, personat të cilët mendojnë se u janë cenuar të drejtat e njeriut, përkatësisht se janë diskriminuar, pavarësisht bazës së diskriminimit, të mund të paraqesin parashtresë deri te Avokati i Popullit, i cili ka detyrim eksplicit t'i mbrojë qytetarët nga diskriminimi, në mënyrë aktive t'i ndjekë problemet e tyre juridike, të marrë pjesë në zgjidhjen e tyre dhe të angazhohet për avancimin e kuadrit ligjor në lidhje me mosdiskriminimin dhe tejkalimin e mangësive të tij.

Pas miratimit të amendamenteve kushtetuese dhe zgjerimit të kompetencës së Avokatit të Popullit për të vepruar në rastet e diskriminimit, ky institucion ka vepruar ndaj parashtresave për diskriminim dhe në një pjesë të tyre ka konstatuar diskriminim. Megjithatë nga praktika e deritanishme shihet një shterpësi në përmbajtjen e mendimeve, meqë situatat nuk sqarohen në detaje, provat nuk prezantohen në detaje dhe në mënyrë të unifikuar, ndërsa rekomandimet shpeshherë nuk janë sa duhet precize.

Parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit ka një vend të rëndësishëm edhe pas pavarësisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut. Kushtetuta parashikon më shumë mundësi për mbrojtje nga diskriminimi të cilat mund të përdoren pavarësisht njëra nga tjetra edhe atë: paraqitje të kërkesës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut për shkak të diskriminimit në Gjykatën Kushtetuese, ngritje të procedurës gjyqësore në bazë të ligjeve nacionale dhe të drejtave të parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe t'i drejtohet Avokatit të Popullit dhe Komisionit për Mbrojtje nga Diskriminimi.



## 2.

**SFIDAT E LIGJIT PËR PARANDALIMIN  
DHE MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI –  
NGA NGRITJA E PROCEDURËS PËR  
VLERËSIMIN E KUSHTETUTSHMËRISË  
SË TIJ DERI NË SHFUQIZIMIN NGA  
GJYKATA KUSHTETUESE**

Rregullimi ligjor i diskriminimit në formën e ligjit të veçantë *lex specialis* në legjisllacionin maqedonas për herë të parë vërehet me miratimin e Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi në vitin 2010, i cili për fat të keq, nuk ofroi harmonizim të plotë me Konventën dhe as me standardet e vendosura të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Nga ana tjetër, diapazoni i bazave të diskriminimit ishte skajshëm kufizues, me ç'rast, mes tjerash, nuk i përmbante edhe ato më sensitivet siç është orientimi seksual dhe identiteti gjinor. Në këtë mënyrë, në të vërtetë, ekzistonte hapësirë për interpretime të ndryshme të dispozitave të caktuara, siç janë dispozitat të cilat kanë të bëjnë me kompetencat dhe funksionimin e Komisionit për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe mundësia për paraqitjen e padisë *actio popularis*.

Ligjvënësi ynë, duke synuar që ta harmonizoj legjisllacionin nacional, me qëllim të inkuadrimit në Bashkimin Evropian, më 16 maj të vitit 2019 e nxori Ligjin e ri për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi.<sup>6</sup> Një pjesë e dispozitave të reja ligjore nxitën debate të mëdha publike dhe ishin subjekt i mosdakordësimit. Zgjerimi i bazave të diskriminimit ishte njëri nga subjektet e mosdakordësimit, veçanërisht bazat e diskriminimit siç është orientimi seksual dhe identiteti gjinor, të cilat u perceptuan se janë në kundërshtim me vlerat e shoqërisë tradicionale maqedonase dhe mundësia e njohjes së mëtutjeshme të martesave të seksit të njëjtë. Sektori qytetar, përmes lobimit aktiv dhe evokimit, arriti t'i ruaj këto kategori si baza të diskriminimit në ligjin e ri. Ligji ofroi zgjidhje më të mira ligjore në krahasim me ligjin paraprak me atë që i parashikoi llojet e diskriminimit, dallimin midis diskriminimit ndërsektorial dhe të shumëfishtë dhe e inkorporoi segregimin si një lloj të veçantë të diskriminimit. Mundësia e paraqitjes së padisë së përbashkët *actio popularis* më mirë është përcaktuar në këtë ligj me ç'rast u ofrohet mundësia shoqatave, fondacioneve, sindikatave dhe organizatave të tjera të shoqërisë civile, të cilat kanë interes të arsyeshëm për mbrojtjen e një grupi të caktuar, ta kenë mundësinë të paraqesin padi, nëse ekziston probabiliteti se me veprimin e të paditurit janë diskriminuar një numër i madh i personave sipas njërës nga bazat e theksuara të diskriminimit.

Madje edhe para nxjerrjes së Ligjit në vitin 2019, Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi ndërmori aktivitete në drejtim të parandalimit dhe detektimit të diskriminimit dhe ishte një mekanizëm i cili mund ta lehtësojë luftën kundër diskriminimit. Çdo person i cili konsideron se është diskriminuar në përputhje me normat kushtetuese dhe ligjore ka mundësi të paraqesë parashtrësë deri te Komisioni i parashikuar me ligj, ose, pavarësisht, të iniciojë procedurë gjyqësore për të dëshmuar ndonjë veprim të diskriminimit.

Megjithatë, që në fillim zbatimi i këtij ligji u ballafaqua me sfida të konsiderueshme të cilat nuk lanë hapësirë të mjaftueshme që të shihen efektet e implementimit të tij. Komisioni paraprak për Parandalimin e Diskriminimit paraqiti iniciativë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, meqë nuk është miratuar me shumicën e nevojshme për herë të dytë pasi që presidenti Ivanov refuzoi ta nënshkruaj dekretin për shpalljen e ligjit.

Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi u miratua nga Kuvendi në procedurë të rregullt me gjithsej 51 vota nga numri i përgjithshëm i deputetëve. Ky ligj i miratuar në këtë

---

6 Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, "Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 101/2019

mënyrë iu dërgua presidentit të atëhershëm Gjorge Ivanov, i cili refuzoi ta nënshkruaj dekretin për shpalljen e ligjit. Së këtejmi, konform procedurës, Ligji u kthye për shqyrtim të sërishëm në Kuvend, kështu që më datë 16 maj të vitit 2019 u miratua me tekst të pandryshuar me gjithsej 55 vota nga numri i përgjithshëm i deputetëve. Presidenti i ri Pendarovski, pasi që e mori detyrën e nënshkroi dekretin për shpalljen e ligjit, dhe pastaj ligji u publikua në "Gazetën Zyrtare të RMV".

Në bazë të iniciativës së paraqitur, Gjykata Kushtetuese, duke e shqyrtuar iniciativën e paraqitur, vendosi të hap procedurë për vlerësimin e kushtetutshmërisë të Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi.<sup>7</sup> Sipas paraqitësit të iniciativës për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë të Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, Ligji qenka miratuar pa shumicën e nevojshme kushtetuese dhe nuk ka pasur mundësi të hyjë në fuqi meqë kanë qenë të nevojshme më së paku 61 vota.

Në këtë fazë u paraqitën reagime në lidhje me çështjen se Komisioni, në momentin e paraqitjes së iniciativës, a ka subjektivitet juridik, përkatësisht Gjykata Kushtetuese a e ka bërë kontrollin e supozimeve të nevojshme procesuale për zhvillimin e procedurës dhe për këtë shkak ka lejuar që si paraqitës së iniciativës të paraqitet Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi.

Në dispozitat kalimtare dhe përfundimtare të Ligjit parashikohet se: (1) Në ditën e hyrjes në fuqi të këtij Ligji pushon mandati i anëtarëve të Komisionit për Mbrojtje nga Diskriminimi, ndërsa vazhdojnë me punë deri në zgjedhjen e anëtarëve të rinjtë, por jo më shumë se tre muaj. Sipas kësaj, parashtrohet pyetja për subjektivitetin procesual dhe Komisioni prej ku e merr legjitimitetin e vet.

Me fjalë të tjera, Komisionit i cili e paraqiti iniciativën ligjërish mandati duhej t'i pushoj pas skadimit të 3 muajve pas ditës së hyrjes në fuqi të Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi. Megjithatë, periudha prej 3 muajsh, të cilën ligjvënësi e ka parashikuar, është periudhë e mjaftueshme që të mund të zgjidhet përbërja e re e Komisionit, të bëhet tranzicioni midis përbërjes së vjetër dhe të re të Komisionit dhe ai të vazhdoj të funksionojë pa pengesa në interes të qytetarëve të cilët do t'i drejtoheshin Komisionit në rast të diskriminimit. Së këtejmi, parashtrohet pyetja se a është plotësuar supozimi procesual për ekzistimin e subjektivitetit juridik të paraqitësit të iniciativës? Edhe përkrah asaj se sipas fuqisë së ligjit ai de jure ekziston, ai nuk merr vendime dhe nuk vepron ndaj parashtrësve, ndërsa kjo çon në faktin se Komisioni de facto nuk funksionon. Megjithatë, në këtë periudhë anëtarët e Komisionit kanë marrë një kompensim të caktuar, që nuk korrespondon me sundimin e së drejtës.

Pastaj, Gjykata Kushtetuese e shqyrtoi çështjen e aspektit procedural në lidhje me miratimin e ligjit nga Kuvendi. Në mbledhjen e mbajtur më datë 14 maj 2020 Gjykata Kushtetuese mori vendim për shfuqizimin e Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi.<sup>8</sup>

Gjykata Kushtetuese, në vendimin e saj, vlerësoi se, meqë ky ligj është vënë përsëri në votim, pasi që paraprakisht Presidenti i Republikës refuzoi ta nënshkruaj dekretin për shpalljen e ligjit, ligji fiton legjitimitet më të madh dhe i njëjti duhet të nxirret me shumicë absolute të votave siç e parashikon neni 75, paragrafi 3 i Kushtetutës, normë e cila, sipas vlerësimit të Gjykatës është normë imperative juridike.

7 Aktvendim i Gjykatës Kushtetuese të RMV, U nr. 115/2019 nga data 28 janar të vitit 2019 <http://ustavensud.mk/?p=18839>

8 Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të RMV për lëndën 155/19, i aksesshëm në <http://ustavensudmk/?p=19246>

Në rastin konkret veprimi juridik i vendimit shfuqizues i Gjykatës Kushtetuese është ex nunc, që do të thotë se akti normativ i shfuqizuar eliminohet vetëm nga rregullimi juridik, por vendimi i Gjykatës nuk është bazë për intervenim në aktet dhe marrëdhëniet e veçanta që janë krijuar nga zbatimi i tij para shfuqizimit. Situata e këtillë nënkupton se Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi pushon të vlejë nga momenti kur Gjykata Kushtetuese e ka miratuar vendimin shfuqizues.<sup>9</sup> Njëherësh Ligji paraprak për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi nuk kthehet në fuqi, meqë Gjykata Kushtetuese nuk e ka rolin e ligjvënësit dhe nuk mund t'i përcaktojë normat, përkatësisht të marr vendime për kthimin në fuqi të ligjeve paraprak të cilët janë bërë të pavlefshëm.

Në mendimin e veçuar të Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut theksohet se dispozita mund të shqyrtohet vetëm në rastet kur Gjykata duhet të vlerësojë se a e ka plotësuar, përkatësisht respektuar Presidenti i Republikës detyrimin e tij kushtetues ta nënshkruaj dekretin për shpalljen e ligjit i cili sërish është shqyrtuar në Kuvend dhe është miratuar me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve dhe jo se a është nxjerr një ligj, përkatësisht miratuar në përputhje me këtë dispozitë.<sup>10</sup>

Duke pasur qasje të drejtpërdrejtë në shënimet stenografike të Kuvendit (të cilat janë publikisht të aksesshme në ueb-faqen [www.sobranie.gov.mk](http://www.sobranie.gov.mk)), është evidente se vendimi për miratimin e parë të Ligjit është nxjerr me shumicën e nevojshme të thjeshtë – më shumë se gjysma nga numri i përgjithshëm i deputetëve të pranishëm në seancë. Pas vendimit të Presidentit që të mos e nënshkruaj dekretin, Ligji u kthye në Kuvend dhe u miratua për herë të dytë, përsëri me shumicë të thjeshtë, përkatësisht me 55 vota “pro” nga gjithsej 101 deputetë të pranishëm në seancë. Megjithatë, shumica e nevojshme për nxjerrjen e ligjeve është përcaktuar në Kushtetutën e RMV, përkatësisht me normën reziduale të Amendamentit X të Kushtetutës dhe të neneve të veçantë të Kushtetutës në të cilët përcaktohet ndonjë shumicë e veçantë, siç është shumica e thjeshtë ose relevante, shumica absolute ose e kualifikuar ose shumica e dyfishtë apo e ashtuquajtura shumica e Bandenterit. Për më tepër, Kushtetuta parashikon shumica të posaçme për ligje të caktuar, por në lidhje me Ligjin në fjalë Kushtetuta nuk parashikon shumicë të posaçme që edhe nëse Kuvendi e ka miratuar ligjin me shumicën e nevojshme, në këtë rast, shumica e votave të deputetëve të pranishëm dhe presidenti ka dashur ta nënshkruaj dekretin, mund të konsiderohet se kjo është në përputhje me Kushtetutën dhe me vullnetin e presidentit.

Neni 75 në paragrafin 3, në këtë kuptim, nuk përcakton se ndonjë ligj që nxirret me shumicë të thjeshtë medoemos duhet të miratohet me shumicë absolute kur miratohet për herë të dytë pasi që presidenti i Republikës paraprakisht ka refuzuar ta nënshkruaj dekretin, por vetëm e potencon detyrimin dhe obligimin Presidenti ta nënshkruaj dekretin për shpalljen e ligjit i cili gjatë shqyrtimit të sërishëm është miratuar me shumicë absolute. Në këtë drejtim, shumica absolute në këtë nen është parashikuar vetëm në drejtim të detyrimit të Presidentit dhe si mekanizëm për detyrimin e nënshkrimit të dekretit për një ligj të caktuar i cili është nxjerrë me shumicën e caktuar, ndërkaq të njëjtin Presidenti nuk dëshiron ta dekretoj.

Me fjalë të tjera, paragrafi 3 i nenit 75 të Kushtetutës përbëhet nga dy fjali të cilat rregullojnë dy situata të ndryshme.

E para, Presidentit të Republikës ia përcakton autorizimin kushtetues të vendos të mos e nënshkruaj dekretin për shpalljen e ligjit. Në përputhje me këtë, në rastin konkret Presidenti

---

9 Gjykata Kushtetuese e RMV, Llojet dhe veprimi juridik i vendimeve, [http://ustavensud.mk/?page\\_id=4601](http://ustavensud.mk/?page_id=4601)

10 Mendim i veçuar për lëndën U. nr. 155/19, i aksesshëm në <http://ustavensud.mk/?p=19247>

i Republikës herën e parë vendosi të mos e nënshkruaj dekretin për shpalljen e Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi.

E dyta, e përcakton detyrimin e Presidentit të Republikës – ta nënshkruaj dekretin për shpalljen e ndonjë ligji të caktuar, i cili krijohet nëse përmbushen në mënyrë kumulative të dyja kushtet e përcaktuara njëkohësisht: (1) Kuvendi përsëri ta shqyrtojë ligjin; dhe (2) nëse e miraton me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve.

Kjo nënkupton se shumica e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve që është parashikuar me dispozitën e njëjtë nuk e paraqet numrin e nevojshëm të votave të deputetëve për nxjerrjen e një ligji, por kjo është shumicë që është njëri nga kushtet e krijimit të detyrimit të Presidentit të Republikës ta nënshkruaj dekretin për shpalljen e një ligji.

Neni 75 i Kushtetutës nuk e rregullon çështjen e shumicës së nevojshme për nxjerrjen e ndonjë ligji, por çështjen e shpalljes, përkatësisht promulgimin e ligjeve. Në këtë dispozitë përdoret shprehja “miraton”, në vend të shprehjes “nxjerr”, të cilën kushtetuta e shfrytëzon për shumicat e nevojshme për nxjerrjen e ligjeve, e që është dallim esencial.

Çështja e legjitimitetit të ligjeve, përmes përcaktimit të shumicave të ndryshme për nxjerrjen e tyre, është një materie e përcaktuar në Kushtetutë, dhe jo diskrecion i Gjykatës Kushtetuese. Sa i përket çështjes së legjitimitetit të cilin e trajton Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj, legjitimiteti i ligjeve është materie e cila rregullohet me Kushtetutë përmes përcaktimit të shumicave të nevojshme të ndryshme për nxjerrjen e ligjeve, dhe nuk lë hapësirë e njëjta të përcaktohet nga Gjykata Kushtetuese. Në të vërtetë, me një interpretim të këtillë, Gjykata Kushtetuese e ndryshon shumicën e cila është e nevojshme për miratimin e ligjeve, dhe e cila është përcaktuar në Kushtetutë.

Me sa duket, rezultati i këtillë nga zbatimi konsekuent i dispozitës së nenit 75 paragrafi 3 të Kushtetutës nuk korrespondon me qëllimin e hartuesit të Kushtetutës sa i përket vetos së Presidentit. Në vendimin për shfuqizimin e Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese ishin të mendimit se vetoja e Presidentit për ndonjë ligj të caktuar duhet ta rris pragun e nxjerrjes së ligjit në Dhomën Ligjvënëse gjatë votimit të sërishëm, në mënyrë që të mposhtet vetoja e Presidentit. Me sa duket, qëllimi i hartuesit të Kushtetutës gjatë përcaktimit të nenit 75 paragrafi 3 të Kushtetutës konsiston me atë që të vendos rregull të posaçëm të shumicës së nevojshme për nxjerrjen e ligjit të cilit paraprakisht i ka vendosur veto Presidenti i Republikës, ndërkaq ky rregull i posaçëm do ta derogonte rregullin e përgjithshëm të Amendamentit X (neni 69) të Kushtetutës. Madje pas kësaj do të realizohet detyrimi i Presidentit ta dekretojë ligjin e nxjerrë në atë mënyrë. Megjithatë, ajo që është përcaktuar në nenin 75 paragrafi 3 të Kushtetutës nuk korrespondon me qëllimin e këtillë të hartuesit të Kushtetutës ndërsa dispozita e theksuar duhet të zbatohet ashtu siç është përcaktuar.

Instituti për të Drejtat e Njeriut e interpreton ndryshe nenin 75 paragrafin 3 të Kushtetutës dhe ka mendime të ndryshme nga Gjykata Kushtetuese në lidhje me shfuqizimin e Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi. Megjithatë, duhet të potencohet se edhe në kushte të mospasjes së ligjit i cili si *lex specialis* do ta rregulloj diskriminimin, ekziston mundësia për zbatimin e drejtpërdrejtë të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe standardet e vendosura të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Edhe përkrah përpjekjeve të Institutit për të Drejtat e Njeriut që ta mundësojë avokimin e qytetarëve para gjykatave nacionale në procedurat e diskriminimit, në periudhën kohore pas shfuqizimit të ligjit nuk u paraqitën raste për përcaktimin e veprimeve të diskriminimit. Për këtë shkak, nuk iu dha mundësi Konventës të zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë në procedurat gjyqësore, dhe me këtë edhe të krijohet praktikë e re gjyqësore.



### 3.

NDALIMI I DISKRIMINIMIT SIPAS  
KONVENTËS EVROPIANE PËR  
TË DREJTAT E NJERIUT DHE  
STANDARDEVE TË VENDOSURA  
NGA GJYKATA EVROPIANE E TË  
DREJTAVE TË NJERIUT

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut është përfitimi më i rëndësishëm në sistemin e mbrojtjes të të drejtave të njeriut në kuadër të Këshillit të Evropës dhe dëshmi për vendosmërinë e Këshillit të Evropës të sigurojë një kohezion më të madh midis shteteve-anëtare përmes respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Konventa është një dokument detyrimor juridik për të gjitha shtetet që e kanë ratifikuar dhe janë dakordësuar të sigurojnë kushte për realizimin e të drejtave themelore të njeriut në kuadër të sistemit të tyre kombëtar. Këtë vit, Konventa e feston jubileun e vet, përkatësisht 70 vjetorin nga nënshkrimi i saj. Në dekadat e kaluara Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut konstatoi shkelje të të drejtave nga Konventa, dhe veçanërisht të nenit 14 i cili ka të bëjë me ndalimin e diskriminimit. Për më tepër, neni 14 parashikon se: “Gëzimi i të drejtave dhe lirive të përcaktuara në këtë Konventë, do të sigurohet për të gjithë, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër”.<sup>11</sup>

Nëse i bëhet një retrospektivë praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në lidhje me nenin 14, atëherë mund të konstatohet se në fillim ky nen nuk ka vepruar në mënyrë të pavarur, por vetëm në raste të shkeljes facie të të drejtave të njeriut, përkatësisht çdoherë është ndërlidhur me ndonjë nen tjetër të Konventës, më së shpeshti me të drejtën e jetës private dhe familjare. Këtë situatë Gjykata e ka elaboruar në Belgian Linguistic Case<sup>12</sup>, kku thotë: “Mbrojtja në kuadër të nenit 14 nuk ka funksionim të pavarur në kuptimin e asaj se neni 14 lidhet vetëm me të drejtat dhe liritë të përcaktuara në Konventë.

Në përputhje me Konventën, diskriminimi mund të jetë rezultat jo vetëm i trajtimit të ndryshëm të njerëzve në situata të ngjashme, por edhe të ofrimit të trajtimit të njëjtë të njerëzve në situata të ndryshme, kur bëhet fjalë për diskriminimin e tërthortë të cilin Gjykata Evropiane e përcakton si “dallimi gjatë trajtimit mund të ketë formë të efekteve joproporcionale paragjyquese mbi politikën e përgjithshme ose masën e cila edhe pse bazohet në kushte neutrale, diskriminon një grup”.<sup>13</sup>

Çështjet që kanë të bëjnë me diskriminimin janë rregulluar edhe në nenin 1 të Protokollit nr. 12 të Konventës i cili e zgjeron shtrirjen e ndalimit të diskriminimit dhe garanton trajtim të barabartë gjatë gëzimit të të gjitha të drejtave. Sipas Raportit shpjegues të Protokollit, ai u hartua me qëllim që ta përforcoj mbrojtjen nga diskriminimi, e që nga ana tjetër konsiderohet se është element thelbësor për garantimin e të drejtave të njeriut. Më konkretisht, Protokollin rezultoi nga një sërë debatesh për mënyrën e përforcimit të barazisë gjinore dhe racore.<sup>14</sup>

---

11 Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut ETS nr.15 [https://www.echr.coe.int/Documents/Convention\\_MKD.pdf](https://www.echr.coe.int/Documents/Convention_MKD.pdf)

12 Belgian Linguistic case (No. 2) (1968) 1 EHRR 252

13 GjEDNj, D.H. and Others v. the Czech Republic [Dhoma e Madhe] (nr. 57235/00), 13 nëntor viti 2007, paragrafi 184; GjEDNj, Opuz v. Turkey (nr. 33401/02), 9 qershor viti 2009, paragrafi 183; GjEDNj, Zarb Adami v. Malta (nr. 17209/02), 20 qershor viti 2006, paragrafi 80.

14 Në vitin 2000 u miratua Protokollin 12 ndaj KEDNj, me ç'rast në njëfarë mënyre plotësuese u zgjerua çështja e mbrojtjes nga diskriminimi. Protokollin 12 ndaj KEDNj, në Republikën e Maqedonisë së Veriut, hyri në fuqi në vitin 2005.



Neni 1 i Protokollit 12 parashikon se:

1. "Gëzimi i çdo të drejte të parashikuar me ligj duhet të sigurohet pa asnjë diskriminim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër."
2. Askush nuk duhet të diskriminohet nga një autoritet publik për ndonjë nga arsyet e parashikuara në paragrafin 1 "Protokolli 12 ofron mundësi për ndalim të përgjithshëm të diskriminimit dhe ai është rezultat i qëndrimit gjithnjë e më të pranishëm se diskriminimi duhet të eliminohet në mënyrë sa më efikase.

Protokolli nr. 12 e ndalon diskriminimin sa i përket "gëzimit të ndonjë të drejte të parashikuar me ligj" dhe së këtejmi ai ka një shtrirje më të gjerë sesa neni 14 i cili ka të bëjë vetëm me të drejtat e garantuara me KEDNj. Sipas komentit që ka të bëjë me domethënien e këtyre nocioneve në Raportin shpjegues të Këshillit të Evropës, dispozita në vijim ka të bëjë me diskriminimin:

- gjatë gëzimit të cilësdo qoftë të drejte të cilën legjislacioni kombëtar konkretisht ia ofron individit;
- gjatë gëzimit të të drejtës e cila mund të nxirret nga detyrimi i qartë i ndonjë autoriteti shtetëror i përcaktuar me legjislacionin kombëtar, përkatësisht kur në përputhje me ligjet kombëtare ndonjë autoritet publik ka detyrim të sillet në mënyrë të caktuar;
- nga autoriteti publik, gjatë kryerjes së autorizimeve të diskrecionit (për shembull, ndarja e subvencioneve të caktuara);
- Përmes ndonjë akti ose lëshimi tjetër nga autoriteti publik (për shembull, sjellja e pjesëtarit të policisë gjatë kontrollit të trazirave). "Protokolli parimisht i mbron individët nga diskriminimi të cilin e bënë shteti, por ai ka të bëjë edhe me marrëdhëniet e personave privat, për të cilët zakonisht konsiderohet se rregullohen nga ana e shtetit, "për shembull, refuzimi arbitrar i qasjes në punë, qasjes në restorante ose në shërbime të cilat i sigurojnë personat privat për publikun, siç është trajtimi mjekësor ose shërbimet komunale të llojit furnizim me ujë dhe energji elektrike".

Protokolli parimisht i mbron individët nga diskriminimi të cilin e ushtron shteti, por ai ka të bëjë edhe me marrëdhëniet midis personave privat, për të cilët zakonisht mendohet se janë rregulluar nga ana e shtetit "për shembull, refuzimi arbitrar i qasjes në punë, qasjes në restorante ose në shërbime të cilat i sigurojnë personat privat për publikun, siç është trajtimi mjekësor ose shërbimet komunale të llojit furnizim me ujë dhe energji elektrike". Marrë në përgjithësi, Protokolli 12 e ndalon diskriminimin jashtë konteksteve të pastra personale, ku individët kryejnë funksione të cilat i vënë në pozitë të vendosin për mënyrën e ofertës së shërbimeve dhe mallrave publikisht të aksesshëm.<sup>15</sup>

Sa i përket përcaktimit të diskriminimit në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, si baza të diskriminimit, fillimisht do ta theksojmë rastin Richards të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (GJED), dhe pastaj do t'i bëjmë një vështrim praktikës së Gjykatës Evropiane për të

15 Për shembull, GjEDNj, Weller v. Hungary (nr. 44399/05), 31 mars të vitit 2009 (Asistencë për fëmijë në pagesën për sigurim social). Protokolli 12 ndaj Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Përmbledhja e marrëveshjeve evropiane nr. 177), Raporti shpjegues, paragrafi 22, <http://conventions.coe.int/Treaty/en/Reports/Html/177.html>

Drejtat e Njeriut e cila është më gjithëpërfshirëse në lidhje me këto baza të diskriminimit. Në rastin Richards, ankuesja i është nënshtruar operacionit për ndryshimin e seksit (nga burrë në grua). Kur i ka mbushur 60 vjet ka dashur të paraqesë kërkesë për pensionim, meqë në atë moshë gratë në Mbretërinë e Bashkuar kanë të drejtë të pensionohen. Qeveria e ka refuzuar kërkesën për pension, duke i thënë se paditësja nuk ka pasur trajtim të papërshtatshëm në krahasim me të tjerët që janë në situatë të ngjashme. Autoritetet kanë pohuar se krahasimi adekuat në këtë rast duhet të jenë "burrat", meqë ankuesja jetën e vet e ka jetuar si burrë. GjED ka vendosur se meqë ligjet kombëtare lejojnë që individit ta ndryshoj seksin krahasuesi adekuat në këtë rast duhet të jenë "gratë". Rrjedhimisht me këtë, ankuesja i është nënshtruar trajtimit të pafavorshëm për dallim nga gratë e tjera me atë që i imponohet moshë më e lartë për pensionim.<sup>16</sup>

Në praktikën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut veçohen disa raste më të rëndësishme të cilat e prekin orientimin seksual dhe identitetin gjinor. Kështu që në rastin Christine Goodwin bëhet fjalë për një person transseksual post-operativ që identifikohet si grua. Në periudhën kur akoma është sjell si burrë, ka qenë në martesë me një grua, megjithatë, bindjet e saj kanë qenë se edhe pse nga aspekti trupor duket si burrë, megjithatë truri i tij e percepton si grua. Ajo është ankuar për diskriminim gjatë pagesës së kontributeve për sigurim kombëtar, meqë sipas ligjit, ajo është burrë dhe për këtë shkak ka qenë e detyruar t'i paguaj kontributet deri në moshën 65 vjeçare, ndërsa nga ana tjetër nëse do ta njihnin si grua, do të kishte të drejtë t'i paguaj kontributet deri në përbushjen e moshës 60 vjeçare. Kjo për shkak se numri i saj i sigurimit nuk është ndryshuar dhe është identifikuar me numra të cilët e vënë në dukje se bëhet fjalë për burrë, dhe jo për grua. Mungesa e rregullimit ligjor të seksit të ndryshuar është shkak për përvoja të shumta diskriminuese dhe përcmuese me të cilat është ballafaquar ankuesja në vendin e punës, por edhe në jetën e përditshme.

Gjatë miratimit të vendimit, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut u referohet rasteve Rees v. the United Kingdom и Cossey v. the United Kingdom ku parapakisht ka konstatuar se nuk ekziston detyrimi pozitiv për Qeverinë ta avancoj sistemin ekzistues për regjistrimin dhe lëshimin e certifikatave të lindjes. Në rastin Rees nga viti 1986 ka ekzistuar pranueshmëri e dobët nga ana e shtetit për personat të cilët kanë dashur ta ndryshojnë seksin dhe për këtë shkak nuk ka pasur konsensus të përbashkët gjatë rregullimit të të drejtave të transseksualëve midis shteteve-anëtarë të Këshillit të Evropës. Megjithatë, edhe pse Gjykata nga aspekti formal nuk është e lidhur me aktgjykimet e veta paraprake, por në interes të sigurisë juridike dhe respektimit të barazisë para ligjit, nuk duhet të reterojë nga aktgjykimet e veta paraprake, përveç nëse nuk ekziston ndonjë shkak i mirëfilltë për një reterim të këtillë. Nga kjo rezulton se në këtë rast Gjykata bën interpretim dinamik, përkatësisht evolutiv të Konventës, duke theksuar se është jashtëzakonisht e rëndësishme Konventa të zbatohet dhe interpretohet në mënyrë efektive, jo në mënyrë teorike ose iluzore. Perceptimi i Gjykatës nga viti 1980 u ndryshua sa u përket problemeve serioze me të cilat ballafaqohen transseksualët, si dhe sa i përket nevojës për ndërmarrjen e masave me të cilat do t'u mundësohet t'i gëzojnë të drejtat e njëjta si edhe të njerëzve të tjerë.

Duke i pasur parasysh rrjedhat shoqërore, ndryshimet e perceptimit të shteteve për çështje të caktuara të cilat e prekin diskriminimin mbi baza të ndryshme të diskriminimit, në vendimet më të fundit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut mund të vërehet tendencë e pavarësimi të nenit 14, i cili ka të bëjë me ndalimin e diskriminimit dhe nenin 1 të Protokollit 12 të Konventës. Në rastin Sejdic and Finci kundër Bosnjë e Hercegovinës, Gjykata ka konstatuar shkelje të nenit 14 të Konventës në lidhje me nenin 1 të Protokollit 12, me ç'rast ka theksuar se derisa neni 14 e

---

16 GjED, Richards v. Secretary of State for Work and Pensions, lënda C-423/04 [2004] ECR I-3585, 27 prill, viti 2006.

ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të Konventës, neni 1 i Protokollit 12 e zgjeron shtrirjen e mbrojtjes dhe e inkorporon ndalimin e përgjithshëm të diskriminimit.<sup>17</sup>

Aplikantët një rom dhe një hebre janë ankuar për trajtim të pabarabartë në lidhje me të drejtën pasive të zgjedhjes. Sipas kuadrit aktual ligjor në BeH të drejtë pasive të zgjedhjes për pozicione të caktuara kanë vetëm boshnjakët, serbët dhe kroatët. Në këtë rast Gjykata konsideron se madje as aranzhmanet e pas luftës të bëra për ruajtjen e paqes midis grupeve etnike që kanë qenë në konflikt, të cilët në sistemin aktual paraqiten si tre popuj konstituiv të BeH nuk mund ta arsyetojnë trajtimin e ndryshëm vetëm mbi bazë të përkatësisë etnike.

Në janar të vitit 2019 Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut e nxori aktgjykimin e parë kundër shtetit tonë në rastin X v. Macedonia. Kjo lëndë është veçanërisht interesante dhe prandaj do të elaborohet në këtë analizë me qëllim që të pasqyrohet sjellja e shtetit tonë ndaj pabarazisë gjinore, si dhe trajtimi diskriminues i institucioneve ndaj personit X vetëm për shkak të identitetit të tij të ndryshëm gjinor. Ankuesi, i cili është person transgjinor është ankuar se nuk ka kornizë ligjore dhe mjet efikas për njohjen ligjore të gjinisë dhe se ekziston imponimi arbitrar dhe i paarsyeshëm i kushtit për t'iu nënshtruar kirurgjisë gjenitale me qëllim që ta ndryshoj shenjën e vet të seksit/gjinisë në evidencën e amzës. Në këtë rast është zbatuar neni 8 në lidhje me mungesën e kuadrit ligjor për njohjen e ligjshme të identitetit të tij gjinor dhe kushtit, i cili nuk ka bazë në legjisllacionin vendas, ai t'iu nënshtrohet ndërhyrjes kirurgjikale gjenitale si parakusht që t'iu njihet identifikimi i gjinisë së tij (mashkullore). Sipas nenit 13, ankuesi ka theksuar se nuk ka mjet juridik efektiv.<sup>18</sup>

Gjykata ka qenë e mendimit se edhe pse çështja esenciale e nenit 8 është t'iu mbrojtë individët nga ndërhyrja arbitrare e pushtetit, mund të imponojë detyrime të caktuara pozitive ndaj shtetit që ta sigurojë respektimin efektiv të të drejtave të mbrojtura me nenin 8. Ky nen, shteteve ua imponon detyrimin pozitiv t'iu sigurojnë qytetarëve të tyre të drejtën efektive të respektimit të integritetit fizik dhe psikologjik. Ky detyrim mund ta përfshijë miratimin e masave konkrete, duke e përfshirë edhe dispozitën për mjetet efektive dhe të aksesshme për mbrojtjen e së drejtës së respektimit të jetës private. Masat e këtilla mund ta përfshijnë edhe sigurimin e kornizës rregullatore gjyqësore dhe makinerisë për ekzekutim që i mbron të drejtat e individëve dhe zbatimin, kur korrespondon me këto masa në kontekste të ndryshme. Pikërisht për këtë shkak Gjykata vëren se nuk ekziston dispozitë në legjisllacionin maqedonas në lloj të ligjit i cili në mënyrë eksplicite e lejon ndryshimin e shenjës së seksit/gjinisë në evidencën e amzës, për dallim nga e drejta e ndryshimit të emrit personal. Me qëllim të ekzekutimit të aktgjykimit, Qeveria e ngarkoi Drejtorinë për Evidencën e Amzës ta aprovoj kërkesën e ankuesit, por Drejtoria u përgjigj negativisht. Për këtë shkak, Komisioni i Shkallës së Dytë në muajin shkurt të vitit 2020 miratoi aktvendim me të cilin e aprovoi ankesën e personit transgjinor dhe dha instruksione që ky person të regjistrohet në Librin e Amzës me numër të ndryshuar të NUAQ. Tani Drejtoria për Evidencën e Amzës duhet të veprojë pozitivisht, me ç'rast aktgjykimi do të konsiderohet si i ekzekutuar dhe personi transgjinor do të mund ta realizoj të drejtën e tij për ndryshimin e numrit të amzës.

---

17 Case of Sejdić and Finci v. Bosnia and Herzegovina, ECtHR, Application no. 27996/06 and 34836/06, December 2009 file:///C:/Users/X/Downloads/001-96491.pdf

18 Rasti X v. Republika e Maqedonisë, Ankesë numër 29683/16, aktgjykim i miratuar më datë 17 janar të vitit 2019.



4.

**SFIDAT DHE MIRATIMI I LIGJIT TË RI  
PËR PARANDALIMIN DHE MBROJTJEN  
NGA DISKRIMINIMI**

Pas shfuqizimit të Ligjit për parandalimin e diskriminimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese u paraqit nevoja e intensifikimit të çështjes për miratimin e Ligjit e që njëkohësisht ishte edhe njëri nga parakushtet e Komisionit Evropian për fillimin e negociatave me Republikën e Maqedonisë së Veriut. Shoqatat e qytetarëve, në mesin e të cilave edhe Instituti për të Drejtat e Njeriut, u bën apel partive politike të cilat morën pjesë në zgjedhjet parlamentare ta mbështesin Deklaratën për miratimin prioritar të Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi nga përbërja e ardhshme parlamentare. Njëherësh, e potencuan rëndësinë e ekzistimit të një ligji të këtillë i cili e mbron të drejtën e garantuar me Kushtetutë të barazisë së qytetarëve, parashikon procedurë për mbrojtje nga diskriminimi, ndërmarrje të masave aktive për parandalimin e diskriminimit dhe promovimin e barazisë të të gjithë qytetarëve, dhe veçanërisht të grupeve të marginalizuara.<sup>19</sup> Në muajin tetor të vitit 2020 deputetët e votuan Ligjin e ri për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, i cili është Ligj gjithëpërfshirës dhe e përfshinë edhe identitetin gjinor dhe orientimin seksual si baza të diskriminimit.<sup>20</sup>

Testi i parë i zbatimit të Ligjit do të jetë zgjedhja e anëtarëve të Komisionit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, i cili duhet të jetë një komision i pavarur, autonom dhe i përkushtuar jo vetëm në zgjidhjen e rasteve të diskriminimit por edhe në parandalimin dhe ndërgjegjësimin për veprimet dhe pasojat e diskriminimit. Për këtë qëllim nevojitet të zbatohet procedurë për zgjedhjen e komisionerëve të ri në mënyrë që qytetarët të kenë mbrojtje më të mirë, më profesionale dhe më efikase të të drejtave dhe lirive themelore. Kriteret e zgjedhjes së anëtarëve të Komisionit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi garantojnë se në këtë autoritet do të zgjidhen persona profesional, fokusi kryesor i të cilëve do të jetë mbrojtja e qytetarëve. Ky Komision do të jetë një organ profesional i përbërë nga shtatë anëtarë. Komisioni i Kuvendit për Çështje të Zgjedhjeve dhe Emërimeve do të ketë detyrë t'i zgjedhë komisionerët, që do të thotë se Kuvendi ka rol të madh dhe mbetet ta ndjekim në kontinuitet procesin e përzgjedhjes dhe punën e anëtarëve të këtij Komisioni, të cilët pritet të jenë profesional dhe të pavarur. Dispozitat ligjore për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk janë garanci e mjaftueshme për pavarësinë e Komisionit dhe nuk e ofrojnë mundësinë për një zgjedhje transparente dhe të pavarur të anëtarëve të Komisionit, ashtu siç u bë përzgjedhja e anëtarëve të Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit.

Siç u theksua më lartë, Ligji ekzistues i përcakton llojet e diskriminimit dhe dallimet midis tyre, e inkorporon segregimin si një lloj i veçantë i diskriminimit dhe parashikon mundësi për paraqitjen e padisë për mbrojtje nga diskriminimi me interes publik (*actiopopularis*), me ç'rast shoqatat, fondacionet, sindikatat ose organizatat e tjera të shoqërisë civile, të cilat kanë interesim të arsyeshëm për mbrojtjen e interesave të një grupi të caktuar, mund të paraqesin padi, nëse ekziston probabiliteti se me veprimin e të paditurit janë diskriminuar një numër më i madh i personave.

Në këtë fazë nuk mund të flasim për efektet nga implementimi i Ligjit, meqë duhet të kaloj një periudhë e caktuar kohore në të cilën ligji do të efektuohet që të mundet në praktikë të dalin dobësitë eventuale, përkatësisht dispozita të cilat në të ardhmen do të duhet të rishikohen dhe përforcohen me qëllim të implementimit më efektiv të tij.

---

19 Apel deri te partitë politike për nënshkrimin e Deklaratës për miratimin prioritar të Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut <https://ihr.org.mk/index.php/en/novosti/povik-do-politichkite-partii-za-potpishuvanje-na-deklaracija-za-prioritetno-donesuvanje-na-zakonot-za-sprechuvanje-i-zashtita-od-diskriminacija-od-strana-na-sobraniето-na-republika-severna-ma>

20 Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, "Gazeta Zyrtare e RMV", Nr. 258, 30.10.2020



5.

**PERCEPTIMI I DISKRIMINIMIT NË  
REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË  
VERIUT ME THEKS TË VEÇANTË  
MBI BAZAT E DISKRIMINIMIT:  
ORIENTIMI SEKSUAL DHE  
IDENTITETI GJINOR**

Diskutimet në lidhje me diskriminimin në shoqërinë maqedonase, dhe veçanërisht kur bëhet fjalë për bazat sensitive, siç është orientimi seksual dhe identiteti gjinor, janë tabu temë. Kjo, nga njëra anë, ka të bëjë me perceptimin e qytetarëve për diskriminimin, si ndonjë problem për të cilin nuk duhet dhe nuk guxon të flitet, ndërsa nga ana tjetër, me indiferencën ndaj njerëzve të diskriminuar, dhe veçanërisht ndaj grupeve të marginalizuara, madje edhe ndaj dukurisë së gjuhës së urrejtjes.

Perceptimi i këtillë, para së gjithash, ka të bëjë me mosnjohjen e nocionit diskriminim, me pasojat e tij mbi individin, por edhe më gjerë, tendencën e mohimit se diskriminimi është problem serioz të cilit çdo shoqëri demokratike duhet t'i përkushtojë vëmendje serioze. Në këtë drejtim është edhe mospasja e praktikës gjyqësore në shtetin tonë me të cilën do të konstatohet diskriminimi, pavarësisht bazave të diskriminimit. Me qëllim të ndërgjegjësimit të popullatës për ekzistimin e diskriminimit dhe parandalimin e tij Instituti për të Drejtat e Njeriut, në bazë të kërkesës për qasje të lirë deri te informacionet, arriti të siguroj statistikë për lëndët e diskriminimit në Gjykatën Themelore Civile Shkup, ku brenda periudhës së viteve 2018-2019 janë evidentuar vetëm dhjetë lëndë gjyqësore që kanë të bëjnë me mbrojtjen nga diskriminimi, e që është një numër dëshpërues, duke e ditur situatën e vërtetë sa i përket prezencës së diskriminimit në të gjitha fushat e jetës shoqërore. Përveç kësaj, asnjëra nga këto procedura nuk kanë të bëjnë me mbrojtjen nga diskriminimi në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor. Për këtë qëllim duhet të locohen problemet, me qëllim të tejkalimit të tyre të suksesshëm. Me sa duket, personat të cilët mendojnë se janë të diskriminuar nuk inkurajohen t'i denoncojnë problemet e tyre para Komisionit për Mbrojtje nga Diskriminimi, kur ky Komision ishte funksional dhe operativ, ose para Avokatit të Popullit, ndërsa ngritja e procedurës gjyqësore është problem plotësues, për shkak të shpenzimeve financiare dhe frikës nga etiketimi i viktimës së diskriminimit dhe ballafaqimit me diskriminuesin (viktimizimi sekondar).

Në periudhën e kaluar Instituti për të Drejtat e Njeriut i përkushtoi vëmendje ndërgjegjësimit për diskriminimin, identifikimin dhe parandalimin e tij, me qëllim të konstatimit dhe sanksionimit të diskriminimit janë fazat e fundit të këtij procesi të gjatë. Për këtë qëllim, u organizuan punëtori në shkollat e mesme dhe në fakultetet brenda shtetit, që pjesëmarrësit të mundën në këtë punëtori të njoftohen me bazat e diskriminimit, duke e përfshirë orientimin seksual dhe identitetin gjinor, aspektet negative të gjuhës së urrejtjes dhe veprat nga urrejtja, si dhe mbrojtjen juridike efektive para gjykatave kombëtare dhe para Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Një aspekt pozitiv është edhe interesimi i madh i të rinjve në shkollat e mesme dhe në fakultete për temat që kanë të bëjnë me diskriminimin. Ata në mënyrë aktive u përfshinë në diskutimet që u zhvilluan në kuadër të punëtorive të mbajtura.

Në mënyrë që të vlerësohet niveli i perceptimit të diskriminimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, me kërkesë të Institutit për të Drejtat e Njeriut u realizuan dy sondazhe. Qëllimi i tyre ishte të vlerësohen mendimet për diskriminimin dhe qëndrimi për miratimin e Ligjit të ri për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, me synimin që të përcaktohen perceptimet e të anketuarve në lidhje me rrezikun nga diskriminimi të grupeve të ndryshme shoqërore (komunitete etnike, gra, persona të moshuar, persona me aftësi të kufizuara, persona me orientim alternativ seksual ose gjinor), dhe me këtë edhe diskriminimin ta vë në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor në kontekstin e

kategorive të tjera potencialisht vulnerabile. Nga ana tjetër, synimi ishte të përcaktohen qëndrimet e të anketuarve në lidhje me nevojën e Ligjit të ri për mbrojtjen dhe parandalimin nga diskriminimi dhe qëndrimi lidhur me përfshirjen e orientimit seksual si bazë e diskriminimit.<sup>21</sup>

ONga sondazhet e realizuara mund të nxirret një konkluzion i përgjithshëm se, për fat të keq, Republika e Maqedonisë së Veriut është një shoqëri konsiderueshëm homofobike, me një shkallë të lartë të intolerancës dhe qëndrimeve diskriminuese ndaj personave homoseksual dhe transgjnorë. Ekzistojnë dallime të vogla në qëndrimet të cilat rezultojnë nga seksi, vendbanimi, përkatësia etnike, mosha dhe shkalla e arsimit. Me fjalë të tjera, pavarësisht fakteve të këtilla, qëndrimi dominant i qytetarëve është jotolerant dhe diskriminues ndaj personave homoseksual dhe transgjnor (LGBT). Së këtejmi, u konstatua situata si vijon:

- Shumica e qytetarëve janë të mendimit se LGBT nuk janë të diskriminuar, prej të cilëve **35.3%** janë të mendimit se LGBT aspak nuk janë të diskriminuar, **7.7%** mendojnë se nuk janë të diskriminuar dhe **14.4%** mendojnë se janë shumë pak të diskriminuar.
- Një shumicë e madhe e qytetarëve, gjithsej **70%**, janë të mendimit se homoseksualizmi është sëmundje.
- Shumicës së qytetarëve (**51%**) u pengojnë burrat homoseksual, dhe gratë lezbike (**49.1%**).
- Një shumicë e konsiderueshme e qytetarëve (**76.2%**) nuk njohin LGBT.
- Thuaja se **2/3** e qytetarëve nuk pranojnë të punojnë me LGBT; **52.4%** nuk do të punonin dhe **9.4%** të tjerë thonë se do të punonin vetëm nëse duhet.
- Më e madhe është pjesa e qytetarëve të cilët nuk pajtohen LGBT të punojnë si mësimdhënës: **53.9%** aspak nuk pajtohen me këtë, **5.5%** nuk pajtohen, dhe **8.1%** të tjerë pajtohen shumë pak. Të ngjashëm janë qëndrimet edhe sa i përket mundësisë LGBT të punojnë si mjekë dhe infermiere: **40.9%** e qytetarëve aspak nuk pajtohen, **6.4%** nuk pajtohen, dhe **7.6%** të tjerë pajtohen shumë pak.
- Më shumë se gjysma e qytetarëve nuk pajtohen LGBT të dalin në lokale të njëjta me persona të tjerë: **40.8%** aspak nuk pajtohen me këtë, **4.6%** nuk pajtohen, dhe **8.3%** të tjerë pajtohen shumë pak.

Duke i pasur parasysh rezultatet e prezantuar më lartë nga sondazhi i realizuar, mund të konstatohet se qytetarët në Republikën e Maqedonisë së Veriut kanë perceptime të shprehura negative ndaj pjesëtarëve të komunitetit LGBT, të shoqëruara me stereotipa dhe refuzim ndaj personave të cilët kanë orientim të ndryshëm seksual nga orientimi përgjithësisht i pranuar heteroseksual. Njëherësh, shumica e qytetarëve janë kundër pjesëtarëve të komunitetit LGBT të jetojnë bashkë dhe lirshëm ta deklarojnë orientimin e tyre seksual ose identitetin gjinor. Është element pozitiv që një përqindje e madhe e popullsisë mendon se nevojitet ligj i ri për mbrojtje nga diskriminimi në të cilin duhet të ndalohet diskriminimi i pjesëtarëve të komunitetit LGBT.

Kjo analizë e vënë në pah nevojën në mënyrë më intensive të punohet në ndërgjegjësimin e qytetarëve për ekzistimin e diskriminimit, çka nënkupton ai, cilat janë pasojat nga veprimet e diskriminimit, me qëllim që të zhvillohet empatia dhe respektimi i diversiteteve midis njerëzve.

---

21 Vlerësimi i mendimit publik dhe niveli i perceptimit të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, si baza për përcaktimin e diskriminimit, <https://ihr.org.mk/storage/app/media/Publications/>





**PIKËPAMJE PËRFUNDIMTARE**

Rendi kushtetues, identifikimi i diskriminimit dhe mekanizmat e mbrojtjes nga i njëjti vërehen edhe pas pavarësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në vitin 1991. Nga aspekti i përfshirjes ligjore të diskriminimit mund të flitet prej vitit 2010, kur u miratua Ligji i parë për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi dhe u parashtruan ankesa në Komisionin për Mbrojtje nga Diskriminimi, i cili vepronte ndaj të njëjtave, megjithatë numri i procedurave të ngritura gjyqësore ishte i papërfillshëm. Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi nga viti 2019, nuk e pati mundësinë ta dëshmojë implementimin e tij në praktikë, meqë Ligji u kontestua në Gjykatën Kushtetuese, ndërsa në ndërkohë nuk u zgjodh komisioni i ri.

Pas shfuqizimit të Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi nga ana e Gjykatës Kushtetuese, u krijua një vakum si rezultat i mosekzistimit të ligjit *lex specialis* i cili do ta trajtojë diskriminimin. Megjithatë, qytetarët kishin mundësi të iniciojnë procedura gjyqësore përmes zbatimit të drejtpërdrejt të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përkatësisht nenit 14 dhe nenit 1 të Protokollit 12 ndaj Konventës, të cilët e ndalojnë diskriminimin. Për fat të keq, kjo mundësi nuk u shfrytëzua nga qytetarët dhe nuk u krijua praktika gjyqësore në Republikën e Maqedonisë së Veriut në sajë të zbatimit të drejtpërdrejtë të Konventës, mundësi të cilën e ofron Kushtetuta në bazë të nenit 118, ku parashikohet se të gjitha marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare bëhen pjesë të rendit të brendshëm shtetëror dhe nuk mund të ndryshohen me ligj. Së këtejmi, nuk u inkorporuan as standardet e vendosura nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

Në muajin tetor të vitit 2020, pas shfuqizimit të ligjit paraprak dhe mbajtjes së zgjedhjeve parlamentare, u miratua Ligji i ri për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, i cili shkon një hap përpara, përkatësisht i zgjeron bazat e diskriminimit, i përcakton llojet e diskriminimeve, e avancoon parimin e barazisë, e lehtëson identifikimin e diskriminimit, e fuqizon rolin e Komisionit, veçanërisht sa i përket parandalimit të diskriminimit dhe e parashikon mundësinë e paraqitjes së padisë së përbashkët *actio popularis*.

Në këtë fazë, implementimit të ligjit në praktikë duhet t'i lihet një kohë e duhur, njerëzit të njoftohen me përmbajtjen e tij, dhe pas kësaj të zhvillohen debate se a nevojiten ndërhyrje të caktuara në ligj, me qëllim të ndryshimit dhe plotësimit të tij.

Duhet t'i përkushtohet vëmendje serioze ndërgjegjësimit të njerëzve lidhur me ekzistimin, parandalimin dhe identifikimin e diskriminimit. Edhe përkrah literaturës së bollshme e cila e trajton diskriminimin në formë të teksteve shkollore, manualëve, udhëzuesve, analizave, standardeve të vendosura nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, megjithatë, me sa duket në shtetin tonë njerëzit nuk e identifikojnë diskriminimin, nuk inkurajohen ta denoncojnë ose të iniciojnë procedura gjyqësore para gjykatave kombëtare. Perceptimi i Republikës së Maqedonisë së Veriut si një shoqëri konsiderueshëm homofobike, duhet të ndryshohet, ndërsa një gjë e këtillë mund të arrihet vetëm përmes diskutimit të hapur dhe transparent për diskriminimin, për ekzistimin e grupeve të marginalizuara dhe për të drejtat e tyre të njeriut dhe e gjithë kjo me synimin që të arrihet një nivel i respektimit të dallimeve të ndërsjella dhe jetesës në një shoqëri të përbashkët e cila nuk do t'i diferencojë njerëzit për shkak të ndonjë tipari të tyre siç është seksi, mosha, përkatësia etnike, përkatësia në ndonjë grup të marginalizuar, orientimi i ndryshëm seksual, identiteti gjinor si dhe mbi baza të tjera të diskriminimit.

## BIBLIOGRAFIA:

1. Vlerësimi i mendimit publik dhe niveli i perceptimit të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, si baza për përcaktimin e diskriminimit, i aksesshëm në <https://ihr.org.mk/storage/app/media/Publications/>
2. Apel deri te partitë politike për nënshkrimin e Deklaratës për miratimin prioritar të Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut <https://ihr.org.mk/index.php/en/novosti/povik-do-politichkite-partii-za-potpishuvanje-na-deklaracija-za-prioritetno-donesuvanje-na-zakonot-za-sprechuvanje-i-zashtita-od-diskriminacija-od-strana-na-sobranieto-na-republika-severna-ma>
3. Protokollu 12 ndaj Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, Përmbledhje e marrëveshjeve evropiane nr. 177,
4. “Gazeta Zyrtare e Republikës Socialiste të Maqedonisë” nr.25/1977, “Ligji penal i Republikës Socialiste të Maqedonisë”. Службен весник на РСМ бр.52/1991, „Устав на Република Северна Македонија”
5. Gazeta Zyrtare e RMV, nr. 52/1991, “Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut”
6. Gazeta Zyrtare e RMV, nr. 101/2019, “Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi”
7. Gazeta Zyrtare e RMV, nr. 258, 30.10.2020 “Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi”
8. Këshilli i Evropës, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut ETS nr.15
9. Gjykata Kushtetuese e RMV, Mendim i veçuar për lëndën U. nr. 155/2019 <http://ustavensud.mk/?p=19247>
10. Gjykata Kushtetuese e RMV, Vendim U. nr.155/2019 i aksesshëm në <http://ustavensud.mk/?p=19246>
11. Gjykata Kushtetuese e RMV, Aktvendim U. nr.115/2019, i aksesshëm në [http://ustavensud.mk/?page\\_id=4601](http://ustavensud.mk/?page_id=4601)
12. Уставен суд на РСМ, Решение У.бр.115/2019, достапно на <http://ustavensud.mk/?p=18839>
13. Gjykata Kushtetuese e RMV, Rregullorja e Gjykatës Kushtetuese të RMV, e aksesshme në [http://ustavensud.mk/?page\\_id=4605](http://ustavensud.mk/?page_id=4605)
14. Kushtetuta e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, viti 1974.
15. Caca Nikollovska, Margarita. 2019. “Kudri ligjor i diskriminimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut: retrospektivë historike dhe pikëpamje aktuale. Dialogu juridik nr. 20, i aksesshëm në: <https://www.ihr.org.mk/storage/app/media/Legal%20Dialogue/%D0%9F%D1%80%D0%B0%D0%B2%D0%B5%D0%BD%20%D0%B4%D0%B8%D1%98%D0%B0%D0%BB%D0%BE%D0%B3.pdf>

### **Praktika e Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut**

1. Belgian Linguistic case (No. 2) (1968) 1 EHRR 252
2. D.H. and Others v. the Czech Republic Application no. 57235/00)
3. Opuz v. Turkey, Application no. 33401/02
4. Zarb Adami v. Malta, Application no.17209/02
5. Weller v. Hungary, Application no. 44399/05
6. Sejdić and Finci v. Bosnia and Herzegovina, ECtHR, Application no. 27996/06 and 34836/06
7. X v. Republika e Maqedonisë, Ankesë numër 29683/16, aktgjykim i miratuar më datë 17 janar të vitit 2019

### **Praktika e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë**

1. Richards v. Secretary of State for Work and Pensions, C-423/04 [2004] ECR I-3585

